



ALBPETROL SHA
RAPORTI I ECURISË SË VEPRIMTARISË
PERIUDHA VJETORE 2022

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Kush jemi.....	3
Modeli i biznesit.....	4
Treguesit kryesorë për vitin që mbyllëm	5
Prodhimi dhe shitja e naftës.....	6
Shitja e energjisë.....	8
Objektivat tona.....	9
Rreziqet kryesore dhe menaxhimi i tyre	10
Tematika jofinanciare.....	11
Çështjet mjedisore.....	11
Çështjet sociale dhe të punonjësve.....	13
Drejtimi i brendshëm dhe kontrolli	16
Politikat e drejtimit.....	16
Kontrolli i brendshëm.....	16
Raportimi i pagesave për institucionet shtetërore	17

Hyrje

Ky raport është hartuar në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara në ligjin 25/2018, i cili kërkon që njësitë ekonomike të publikojnë një analizë gjithëpërfshirëse të veprimtarive dhe rezultateve financiare dhe jofinanciare, përfshi rreziqet dhe pasiguritë kryesore me të cilat përballet njësia.

Raporti mbulon periudhën vjetore 2022 dhe së bashku me pasqyrat financiare përbëjnë raportimin vjetor të shoqërisë Albpetrol sha, në përmbushje të përgjegjësive korporative, për transparencë me publikun dhe për një kuptim më të mirë të vetë njësisë ekonomike.

Kush jemi

Numri unik i identifikimit	J82916500U
Emri	ALBPETROL SHA
Data e themelimit	30/04/1999
Adresa e zyrës qendrore	Fier, Patos, L. 29 Marsi
Vlera e Kapitalit	14.735.229.000 Lekë

Shoqëria Albpetrol sha është një shoqëri aksionare me kapital tërësisht publik. Të drejtat e Asamblesë së Përgjithëshme i ushtron Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë në nivelin 100 përqind.

Shoqëria drejtohet nga. Këshilli Mbikëqyrës, dhe nga Administratori. Këshilli mbikqyrës përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

Me 31 Dhjetor 2022, organet drejtuese të shoqërisë përbëhen si vijon.

Z. Ilia Gjermani	Kryetar	Këshilli Mbikqyrës
Znj. Evis Mamaj	Anëtar	Këshilli Mbikqyrës
Z. Ardi Veliu	Anëtar	Këshilli Mbikqyrës
Z. Stefanaq Koçollari	Anëtar	Këshilli Mbikqyrës
Z. Ermal Nufi	Anëtar	Këshilli Mbikqyrës
Znj. Florenca Korbi	Anëtar	Këshilli Mbikqyrës
Z. Eltar Deda	Administrator	

Modeli i biznesit

Modeli i biznesit të një njësie përshkruan se si njësi gjeneron dhe ruan vlerën përmes kryerjes së veprimtarive. Modeli i biznesit siguron kontekstin e raportit të ecurisë së veprimtarisë në tërësi. Ai siguron një përmbledhje të mënyrës se si funksionon një njësi dhe arsyetimin e strukturës së saj, duke përshkruar se si i shndërron inputet në outpute përmes aktiviteteve të biznesit. Në terma më të thjeshtë, çfarë bën një njësi, si dhe pse e bën atë.

Shoqëria Albpetrol sha zhvillon veprimtarinë kryesore në fushën e operacioneve hidrokarbure në perputhje me Ligjin Nr. 7746, datë 28.08.1993 në Shqipëri.

Realizimi i operacioneve hidrokarbure bëhet nepermjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftembajtës dhe ato gazmbajtëse të vendit, kërkimeve të reja dhe zhvillimit të blloqeve në administrim si dhe shfrytëzim të rërave bituminoze. Duke filluar nga data 01.04.2003, shoqëria zhvillon vetë të gjitha veprimtaritë që kanë të bëjnë me kërkim – prodhimin e hidrokarbureve.

Gjithashtu, operacionet hidrokarbure realizohen edhe nëpërmjet licensë marrëveshjes që zotëron shoqëria Albpetrol sha. License marrëveshja parashikon të drejtën për të kryer operacionet hidrokarbureve në territorin shqiptar si dhe për të transferuar të drejta nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve hidrokarbure me nënkontraktorë të tjerë. Këto marrëveshje parashikojnë ndarjen e prodhimit, ku shoqëria Albpetrol sha përfiton sasi hidrokarbure në natyrë.

Shoqëria ushtron veprimtari në vendburimet e naftës në zonat Kuçovë, Patos, Cakran-Mollaj, Gorisht-Kocul, Amonice-Gorisht dhe Karbunarë. Për vendburimet e gazit në zonën Cakran-Mollaj dhe Kuçovë dhe vendburimi i rërës bituminoze Kasnic-Fier.

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarive të shoqërisë është edhe furnizimi me energji elektrike, kryesisht për nënkontraktorët e operacioneve hidrokarbure dhe kliente të tjerë të kualifikuar. Energjia elektrike sigurohet nga operatorët e licensuar dhe tregtohet në përputhje me kushtet e licensimit nga autoriteti rregullator.

Shoqëria i tregton prodhimet hidrokarbure në tregun vendas dhe aplikon ankandin si metodë për lidhjen e kontratave.

Treguesit kryesorë për vitin që mbyllëm

Për vitin 2022 shoqëria Albpetrol sh.a ka zhvilluar aktivitetin e saj në zbatim të Programit të Zhvillimit Ekonomik të miratuar me vendimet e Asamblese së Përgjithshme të Aksionarit nr.1290/1, date 16/02/2022 dhe nr. 5, date 4/02/2022 të Keshilli Mbikqyres të shoqërisë.

Në tërësi, shoqëria realizoi të ardhura në vlerën 7.07 miliardë lekë, ku peshën kryesore e zë shitja e naftës dhe ajo e energjisë. Ky është një tipar i qëndrueshëm i veprimtarive të shoqërisë.

Një paraqitje përmbledhëse e performancës për 3 vitet e fundit të aktivitetit paraqitet në vijim. Vlerat janë në mijë lekë.

000 lekë	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Shitje naftë	4,975,673	4,080,045	521,175
Shitje gas	4,660	4,381	4,602
Shitje energji	1,970,602	1,508,482	1,359,907
Shitje të tjera	4,138	6,715	8,623
Investime të realizuara	33,134	26,722	52,851
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë	83,120	54,743	154,775
Total të ardhura	7,071,327	5,681,088	2,101,933
Shpenzimet	-6,585,256	-5,545,642	-3,678,220
Fitimi bruto para tatimit	486,071	135,446	-1,576,287

Periudha 2020 u ndikua nga efekti i pandemisë Covid ku tregjet e energjisë dhe hidrokarbureve u tronditën dhe pësuan luhate të mëdha. Si rrjedhim shoqëria regjistroi humbje në këtë periudhë. Efekti i pandemisë duhet marrë në konsideratë në rastin e analizave krahasimore.

Fondi i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme si dhe numri i punonjësve për 3 vitet e fundit të aktivitetit paraqitet në vijim.

	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Shpenzimet për Paga dhe Sigurimet e detyrueshme shoqërore e shëndetësore (në mijë lekë)	1,532,255	1,660,545	1,501,512
Numri mesatar i punonjësve	1,645	1,745	1,686

Politikat e burimeve njerëzore kanë në fokus përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar, zhvillimin e njohurive dhe menaxhimin e performancës. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi, përbëjnë gjithashtu një vlerë të kompanisë.

Prodhimi dhe shitja e naftës.

Gjatë periudhës 2022, është punuar për ndjekjen dhe zbatimin e dy kontratave të shitjes njëra për sasine 100,000 ton që është lidhur midis Albpetrol Sha dhe Europetrol Durres Albania Sha me datë 04.05.2021 dhe tjetra e lidhur midis Albpetrol Sha dhe Bashkimit të Operatoreve RBH Belin & Europetrol Durres Albania Sha për sasine 120,000 ton me datë 03.06.2022.

Çmimi i shitjes së naftës ka qenë në varesë të çmimit Brent i cili gjatë kësaj periudhe ka patur në përgjithësi trend rritjeje nga 3 muajt I, II dhe III dhe pastaj rënie në tremujorin IV. Në kushtet e një trendi rritjeje të çmimit të naftës Brent është rritur edhe çmimi i shitjes së naftës duke ndikuar në përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë. Çmimi mesatar i shitjes gjatë periudhës 2022 ka qenë 51,893 lekë për ton. Shoqëria ka shitur një sasi prej 95,883 ton naftë gjatë periudhës 2022 duke realizuar të ardhura në vlerën 4.98 miliardë lekë.

Shitjet e naftës në sasi dhe vlerë për 3 vitet e fundit të aktivitetit paraqitet në vijim.

	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Naftë e shitur (në tonë)	95,883	120,139	22,415
Çmimi i shitjes (lekë/tonë)	51,893	33,961	23,251
Vlera e shitjeve (në mijë lekë)	4,975,673	4,080,045	521,175

Prodhimi i naftës gjithsej nga veprimtaria e vet Albpetrolit dhe nga zbatimi i Marrveshjeve Hidrokarbure për vitin 2022 është realizuar 104.4 %, duke mbledhur gjithsej 113,725 ton naftë.

Prodhimi i naftës nga vetë Albpetrol.

Nga aktiviteti i vet Albpetrolit prodhimi i naftës është realizuar 70,571 ton kundrejt 75,920 ton të programuar ose 93%. Prodhimi vjetor i naftës nga vet shoqëria është realizuar nga aktiviteti i rreth 1,123 puseve mesatarisht në punë, me një debit mesatar 0.23 ton/dite/pus dhe koeficient shfrytëzimi prej 0.76, tregues këta të cilët erdhën duke u përmirësuar nga njëri muaj në tjetrin deri në përfundim të vitit 2022. Në vijim jepet një tabelë e prodhimit të naftës sipas vendburimeve në ton.


Vendburimi	Programi	Fakti	Mesatare Ditore	Realizimi në %
Patos	5,840	4,723	12.94	81%
Cakran-Mollaj	13,870	12,173	33.35	88%
Kuçovë	18,615	17,406	47.69	94%
Gorrisht-Kocul	32,850	33,128	90.76	101%
Karbunare	365	89	0.24	24%
Amonice	4,380	3,053	8.36	70%
Total	75,920	70,571	193.34	93%

Prodhimi i naftës nga partnerët.

Nga aktiviteti i partnerëve pjesa e Albpetrol e prodhimit të naftës është realizuar 43,154 ton kundrejt 33,052 ton të programuar ose 131%.

Partneri	Programi	Fakti	Mesatare Ditore	Ne %
Bankers Petroleum Albania Ltd.	19,405	29,884	10,479	154%
TerraOil Swiss sh.a	2,658	2,559	-99	96%
Sherwood International Petroleum Ltd.	557	548	-8	98%
Fin - Pek Petroleum sh.a.	80	105	25	131%
Anio Oil & Gaz sh.a	9,833	9,794	-38	100%
Delvina Gaz Company Ltd (kondesat)	520	264	-255	51%
Total	33,052	43,154	10,102	131%

Në vijim paraqitet në mënyrë grafike prodhimi total i naftës për 3 vitet e fundit të aktivitetit. Sasitë e prodhimit janë të shprehura në ton.



Shitja e energjisë.

Gjatë periudhës 2022, të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike janë realizuar 1,970,602 mijë leke nga shitja të treta, kryesisht kompanive kontraktore që operojnë me Marrveshje Hidrokarbure në vendburimet e naftës. Këto të ardhura janë realizuar 129.8% krahasuar me programin, ose me një tejkalim prej rreth 452,548 mijë leke.

Për vitin 2022 shoqëria Albpetrosh.a ka blerë, ka shpenzuar për blerje energji elektrike gjithsej (për vetë dhe rishitje) në vlerën rreth 2.117 miliard leke kundrejt 1.313 miliard leke të programuar me një tejkalim prej 803.8 milion leke ose rreth 161.2 % të programit, në varesi të sasisë energjisë aktive dhe reaktive dhe cmimit përkatës të blerjes/njesisë. Rritja e shpenzimeve të blerjes së energjisë erdhi si pasojë e rritjes së cmimit të blerjes së energjisë elektrike në treg. Shoqëria Albpetrosh.a e ka blerë energjinë aktive që zë edhe peshën kryesore në shpenzimet totale të energjisë me cmimin rreth 18.8 leke/kwh kundrejt 11 dhe 14 leke mesatarisht programuar nga shoqëria.

Bilanci sasior i energjisë elektrike për 3 vitet e fundit të aktivitetit është si më poshtë në mijë kwh.

000 kwh	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Blerje	146,073	138,675	130,182
Konsum vetjak	24,890	22,573	21,336
Shitje	105,480	98,266	91,857
Humbje	15,701	17,845	16,988
Humbje në përqindje	10.75%	12.87%	13.05%

Bazuar në metoda statistikore, është llogaritur kosto e energjisë së shitur dhe në vijim paraqitet një bilanc i aktivitetit të shitjes së energjisë.

000 lekë	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
Shitje energji	1,970,602	1,508,482	1,359,907
Kosto energji e shitur	1,528,936	862,437	809,179
Marzhi bruto	441,666	646,045	550,728

Objektivat tona

Në kryerjen e aktiviteteve nxjerrëse është pasur parasysh gjendja e rezervave të nxjerrshme, gjendja e rezervuarit, niveli tekniko – profesional i punonjësve, gjendja e puseve, kushtet dhe treguesit e shtresës, treguesit e prodhimit të puseve e të objekteve naftë e gaz mbajtëse, infrastruktura sipërfaqësore, logjistika mbështetëse, tregu hidrokarbur, çmimet e naftës bruto në bursë, etj.

Referencë e rëndësishme është dinamika e realizimit të kuotave të prodhimit vjetor të naftës si dhe Studimi teknik mbi strategjinë e zhvillimit të vendburimeve në vitet e ardhshme.

Përcaktimi i kuotave të nxjerrjes së naftës dhe gazit është analizuar në veçanti për çdo vendburim mbi bazën e veçorive të vendburimeve.

Element përcaktues janë veçoritë gjeologjike të shtratimeve, rezervat e nxjerrshme të naftës, faza aktuale e shfrytëzimit të tyre, koeficientët natyror të rënieve.

Situata e përgjithshme e vendburimeve gëlqerore është se ata janë në një stad të avancuar të shfrytëzimit të tyre dhe karakterizohen nga një shkallë e lartë inondimi nga ujrat shtresorë dhe faktor i ulët gazor deri dhe me regjime gravitacionale kryesisht në vendburimet ranore.

Disa veçori do të shtjellohen për çdo vendburim që shfrytëzohet aktualisht. Në këto kushte të përgjithshme prioritet ka qënë dhe mbetet përshtatshmëria e metodave të shfrytëzimit sipas karakteristikave dhe llojit të vendburimeve.

Nisur nga sa më sipër nuk mendojmë projektme dhe shpime të reja pusesh që do të rrisnin numrin aktiv të tyre në shfrytëzim, ndaj mbështetje kryesore do të jetë mbajtja e numrit aktiv të puseve aktuale me punimet e remontit nëntokësor si dhe riaktivizimi i puseve të fondit të ndalur në të gjithë vendburimet, perforime te puseve te vecante, por edhe në projekte pilot për implementimin e metodave të dyta (EOR) siç është ajo e injektimit të polimereve, etj.

Në vëndburimet gëlqerore orientim bazë do të jetë optimizimi i përqindjes së ujit në fluid nëpërmjet regjimeve të shfrytëzimit për çdo grupim pusesh e deri për çdo pus.

Rreziqet kryesore dhe menaxhimi i tyre

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin dhe analizën e risqeve që mund të kenë rëndësi për arritjen e objektivave të institucionit dhe përcaktimin e një përgjegjeje të përshtatshme ndaj këtyre risqeve. Dokumentimi I procesit të menaxhimit të riskut bëhet nëpërmjet regjistrimit të risku ku përfshihet

Identifikimi i risqeve bëhet në nivel njësie dhe nivel veprimtarie, gjithashtu dhe në kategori të jashtëm apo të brendshëm dhe për të gjitha risqet e identifikuara, do të caktohen zotëruesit përkatës të cilët kanë përgjegjësinë që risqet të menaxhohen dhe monitorohen gjatë gjithë kohës.

Albpetrol mbart procedura, të cilat përfshihen në strategjinë për menaxhimin e riskut – për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të venë në rrezik përmbushjen e objektivave të njësisë.

Shoqëria ka disa mosmarrëveshje me kontraktorët kryesorë të marrëveshjeve hidrokarbure dhe ka procese të hapura në arbitrazh ndërkombëtar. Shoqëria nuk ka mundur të vlerësojë efektet e mundëshme që mund të shkaktohen nga këto mosmarrëveshje.

Gjithashtu, shoqëria ka mosmarrëveshje dhe konflikte të cilat zhvillohen në gjykatat e juridiksionit shqiptar.

Per vitin 2022 janë ndjekur gjithsej 365 ceshtje gjyqësore nga te cilat 307 ceshtje gjyqësore janë ndjekur në Gjykatat e Shkallës së Parë Fier, Vlore, Tirane dhe Gjirokaster dhe 58 procese gjyqësore në Gjykatat e Apelit Vlore dhe Tirane.

Proçeset gjyqësore të ndjekura ku shoqëria “Albpetrol” sha Patos, ka qënë në cilësinë e të paditurit, janë me objektet si më poshtë:

- dëmshpërblim për zgjidhjen e marrdhënieve të punës;
- dëmshpërblim për vjetërsi në punë;
- dëmshpërblim ndotje toke;
- konstatim diskriminimi;
- përmbushje detyrime kontratuale;
- detyrimin për të paguar diferencën e pagave për muajt prill, maj dhe qershor;
- njohje e vjetërsisë në punë;
- paga e 13
- orët shtetsë, ditët e festave dhe ditët e diela;
- dëmshpërblim page me punonjësit e transatlantikut.

Numri i proçeseve ka ardhur duke i rritur për shkak të hapjes së proçeseve gjyqësore me objekt pagat e pandemisë.

Çështjet gjyqësore, për të cilat shoqëria “Albpetrol” sh.a i është drejtuar Gjykatës, pra shoqëria Albpetrol sh.a është në cilësinë e palës paditëse janë me objektet si më poshtë:

- pavlefshmëri titulli;
- kthim shume;
- pavlefshmëri i vendimeve te Komisionierit për mbrojtjen nga Diskriminimi;
- kundërshtim veprimesh përmbaremore, etj.

Për këto procese është bërë vlerësimi i dëmeve që mund të shkaktohen dhe është regjistruar në avancë në pasqyrat financiare një efekt për vlerën 400 milionë lekë.

Tematika jofinanciare

Informacioni jo-financiar i paraqitur nga njësitë jepet për të ndihmuar investitorët dhe palët e tjera të interesuara të kuptojnë dhe monitorojnë performancën e njësisë.

Aspektet tematike shpesh janë të ndërlidhura. Për shembull, një çështje mjedisore që lidhet me aktivitetet, prodhimet ose zinxhirin e furnizimit të një njësie gjithashtu mund të ketë një ndikim në sigurinë dhe / ose shëndetin e konsumatorëve, punonjësve, furnitorëve ose në reputacionin e markës. Njësitë pritet të japin një pamje të qartë, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse që përfshin të gjitha aspektet e rëndësishme të një çështjeje.

Çështjet mjedisore

Shoqeria është e shume e kujdesshme dhe e perkushtuar ne trajtimin e ceshtjeve mjedisore. Shoqeria bashkepunon dhe ka lidhur kontrata te vazhdueshme me studio te specializuara, te pavarura, per trajtimin e ndotjeve mjedisore, perfshi monitorimin dhe trajtimin e shkarkimeve te gazta, ujrave nentokesore dhe siperfaqesore, nivelit te zhurmave, monitorimin e dekantimeve si nje nder burimet me te medha te ndotjes se ajrit, tokes dhe ujrave.

Ndotjet mjedisore

Edhe pergjate vitit 2022 shoqeria Albpetrol.sh.a pjese te punes se saj ka patur dhe monitorimin, ruajtjen dhe zbatimim e ligjshmerise se mjedisit dhe sigurise ne pune, vecanerisht shendetin e punonjesve. Gjate 2022 problem per shoqerine kane ngelur ndotjet te cilat jane te trasheguara si sabiet naftore ne sheshet e puseve, kimikatet e skaduara, baterite e dala jashte perdorimit, eternitet, gomat jashte perdorimit etj.

Zhdëmtimet bujqësore

Edhe pergjate vitit 2022 janë kryer procedurat e zhdëmtimeve bujqësore si pasojë e avarive të ndryshme të ndodhura në Q.P.N. dhe QASHNG sipas Rregullores së Zhdëmtimeve Bujqësore që disponojme, komform ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore” dhe Ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 “Per Mbrojtjen e Mjedisit”.

Nga përlllogaritjet e bëra në akt-vleresimet për fitimin e munguar bujqësor për këtë vit kanë dalë 12 “Urdhëra” për 35 fermerë me një shpenzim total prej 2,912,444 lekë, nga 8,000,000 lekë të planifikuara për vitin 2022.

Në këtë shumë të shpenzuar për vitin 2022 përfshihen edhe dëmtime të tokave bujqësore të shkaktuara nga avari të ndodhura në fund të vitit 2021.

Konkretisht për dëmshpërblimet financiare të tokave dhe kulturave bujqësore për vitin 2021 kane dale 3 urdhera në 6-mujorin e parë të 2022 per te likujduar 5 fermerë me një shumë totale 385,622 lekë. Ndërsa për zhdëmtime bujqësore nga avari të ndodhura në vitin 2022 kane dale 9 urdhera per te dëmshpërblyer 30 fermerë me nje shume prej 2,526,822 lekë.

Faktorët kryesorë që kanë diktuar këto shpenzime për zhdëmtime bujqësore janë kryesisht avari të ndodhura nga çarje të magjistralit të naftës sidomos në periudhën e dimrit për shkaqe të ndryshe teknologjike, rrjedhje gropash avarie dhe seperatorëve, çlirimi i gazit në dekantime dhe grupe

zëvendësime të pjesshme të tubacioneve të transportit të naftës, shkarjet e dherave si rezultat i terrenit kodrinor, sjellin për pasojë zhvendosje e shkëputje të tubacioneve të naftës e gazit, si dhe për shkak të amortizimit dhe korrodimit të tubacioneve të transportit të naftës.

Kryerja e proceseve për eliminimin e avarive ka kërkuar kalimin e mjeteve të rënda nga ana e Qendrave duke shkaktuar dëmtimin e tokave, kulturave bujqësore dhe drufrutorëve të fermerëve.

Duhet theksuar fort se Qendra e Prodhimit më problematike përse i përket avarive të shkaktuara dhe dëmet financiare që i shkaktohen kompanisë Albpetrol është QPN Fier, dhe më konkretisht Sektori Cakran -Mollaj. Shkaqet e këtyre dëmtimeve kanë ardhur si pasojë e amortizimeve të mëdha që kanë linjat e transportit të fluidit nga qendrat Nr 38, Nr 59, Nr 29, drejt Qendrës Nr 17, ku bëhet dhe grumbullimi i fluidit të këtij vendburimi naftë. Gjithashtu ngelet një problem shqetësues permanent edhe linja e transportit të fluidit nga Qendra Nr.17 drejt dekantimit Usojë.

Duhet theksuar se zëvendësimet e pjesëshme nuk e kanë zgjidhur situatën dhe kompanisë tonë i shkaktohen humbje të fluidit, kosto shtesë për zhdëmtimet e fermerëve, si dhe penaltetet e vendosura nga ISHPMUT Fier.

Mbetet detyrë e shoqërisë që të përqendroje vëmendjen tek investimi në linjat e transportit si dhe depozitat e tyre, seperatorët, të cilët duhet ti nënshtrohen rikonstruksioneve të vazhdueshme, në disa raste edhe të plota, pasi shpeshherë është bërë objekt i kontrolleve dhe akuzave nga Institucionet shtetërore dhe lokale, për ndotje të sipërfaqeve tokës, si dhe kanaleve kullues, përrenjëve e lumenjve.

Çështjet sociale dhe të punonjësve

Njësia është e perkushtuar për trajtimin e çështjeve sociale dhe të sigurisë në punë. Kjo për faktin se shoqëria ka një numër të lartë punonjësish si dhe për faktin se industria paraqet rreziqe komplekse për jetën dhe shëndetin në mënyrë permanente.

Burimet njerëzore

Gjatë këtij viti është punuar në drejtim të një miremenaxhimi të burimeve njerëzore duke kryer administrimin e të dhënave bazë të punonjësve, përditësimin e tyre në përputhje me ndryshimet përkatëse, update i plote I dosjeve personale të punonjësve. Një punë e mirë është bërë për ndjekjen dhe zbatimin e Kontratës Kolektive të Punës me Sindikatën e Re Naftëtarëve Shqiptarë, përmirësimin të marrëdhënive dhe respektimit të detyrimeve përkatëse.

Për vitin 2022 shoqëria Albpetrol sh.a. ka ofruar shërbimin e "Sigurimit të jetës dhe shëndetit nga Aksidentet në Punë", për punonjësit e ekspozuar ndaj riskut, bazuar në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 9442 datë 16.11.2005 "Për Ratifikimin e Konventës Nr.102, Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, Kontraten Kolektive të lidhur midis shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe përfaqësuesve të punëmarrësve, Ligjin Nr. 10237 datë 18.02.2010 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë" si dhe Vendimin e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 639 datë 07.09.2016 pika 2 (b), "Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë", për shkak të rrezikshmërisë së lartë të punës në industrinë e naftës dhe të gazit.

Për sa i përket këtij shërbimi është lidhur kontrata e "Shërbim i Sigurimit të punonjësve nga aksidentet në punë", ku numri i pozicioneve të punës që përfitojnë nga ky shërbim është 1,400 vende pune ose punonjës të profesioneve të ndryshme.

Në zbatim të Urdhërit nr.234 datë 11.10.2021 "Për evidentimin e numrit të punonjësve që përfitojnë statusin e naftëtarit sipas ligjit 29/2019 dhe efektit financiar të zbatimit të këtij detyrimi ligjor" të Ligjit nr.29/2019 "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në mëtalurgji", vendimit të KM nr.447 datë 03.06.2020 "Për emërtimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve teknologjike, organizimit e pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk pëputhen apo parashikohen në Vendimin e KM Nr.526 datë 20.12.1958", si dhe vendimit të KM nr.526 datë 20.12.1958 "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni", shoqëria në bashkëpunim me qendrat në varësi ka evidentuar listën e punonjësve që përfitojnë trajtim financiar në përputhje me nenin 8 të Ligjit nr.29/2019. Trajtimi financiar i punonjësve sipas Ligjit nr.29/2019 ka filluar prej muajit Janar 2022 dhe vazhdoj deri me 31 Dhjetor 2022. Konkretisht për vitin 2022, shoqëria "Albpetrol" sh.a. ka trajtuar financiarisht mesatarisht 702 punonjës.

Është bashkëpunuar me Departamentin e Administratës Publike "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në zbatim të ligjit Nr.138/2015.

Sigurimi teknik

Per kete I kushtohet rendesi njohjes dhe zbatimit te rregulloreve te sigurimit teknik si dhe investimeve ne rinovimin e teknologjise dhe pajisjeve qe perdoren.

Gjithashtu shoqeria ka lidhur kontrata per sigurimin e jetes se punonjesve ne pozicionet me rrezikshmeri te larte. Ka kontrata me pale te treta te pavarura per kontrollin e eneve ne presion. Kryhen kontrole mjekesore per punonjesit te pakten 2 here ne vit.

Zbatohen rregullisht pagesat per ndihma ekonomike si dhe per zhdemtimin e tokave bujqesore.

Jane ndermarre masat e duhura per sigurine ne pune, ne kushtet qe industria e naftes eshte komplekse ku rreziqet per shendetin jane permanente, pasi kemi te bejme me ngarkesa te renda, rreziqe elektrike, forca madhore natyrore, mjete te renda levizese, pune nentoksore etj. Po keshtu eshte lidhur kontrata e sigurimit te jetes per 1400 punonjesit qe punojne ne vendet me rrezikshmeri te larte.

Edhe gjate vitit 2022 ka vazhduar te kryhet njohja dhe zbatimi i Rregullores te Sigurimit teknik ne industrine e naftes per te gjithë punonjesit nga specialistet perkates ne cdo qender te shoqerise dhe vecanerisht me e detajuar per punonjesit e emeruar rishtazi .

Kontrollet mjekesore

Nje pune e mire nga shoqeria pergjate kesaj periudhe eshte bere ne drejtim te mbrojtjes se shendetit te punonjesve te shoqerise . Albpetrol.sh.a ka tashme nje program te kontroleve mjekesore te miratuar qe aktualisht zbatohet nga personeli mjeksor prane QEMNG Patos.

Mbeshtetur ne kete program per periudhen vjetore janë realizuar kontrole mjekesore per Administraten dhe 10 Qendrat sipas grafikut te miratuar. Kontrollet mjekesore janë kryer edhe në zbatim të kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit “Sigal” si gjashtë mujor kanë përfunduar egzaminimet nga mjeku i shoqërisë Albpetrol sh.a 1665 punonjës nga te cilet 144 punonjës jane evidentuar të prekur me Covid-19 dhe nuk ka patur asnje humbje jete prej Covid-19.

Ndihmat ekonomike.

Ne zbatim te Kontrates Kolektive lidhur midis shoqerise dhe “Sindikatës se Re të Naftëtarëve Shqiptarë” ne Programin e Zhvillimit te Albpetrol. Sh.a per vitin 2022 sigurisht edhe per vitin qe analizojme, janë parashikuar dhe miratuar ndihma ne raste semundjesh dhe fatkeqesish per punonjesit e shoqerise.

Shpenzimet e dhena per ndihma ekonomike ne perputhje me kontraten kolektive jane 8,850 mije leke ose 3,350 mije leke më shumë krahasuar me ato te programuara. Per kete vit, kanë përfituar ndihma ekonomike 133 punonjës.

Ne 3 mujorin e I-re jane likujduar edhe disa ndihma te prapambetura nga viti i kaluar ne vleren 590 mije leke. Keto shpenzime jane tejkualuar, krahasuar me programin e ketij viti. Likujdimi I tyre ka qene ne varesi te rasteve te ndodhura dhe gjendjes financiare te shoqerise.

Nga specialistet perkates te kujdesit shendetsor dhe drejtoria e mjedisit jane evidentuar te gjitha rastet e ndodhura sipas kontrates detajuar ne qendra, diagnozat perkatese mjekesore dhe mbeshtetja ligjore per marrjen e vendimeve perkatese nga drejtuesit e shoqerise e vlerat e akordura financiare.

Aksidentet në punë

Gjatë këtij viti ka ndodhur 4 aksidente në punë, ku shoqëria Albpetrol nepermjet drejtorise dhe specialisteve perkates ka ndjekur gjithë procedurat ligjore dhe ka bërë analiza te detajuara per cdo rast aksidenti.

Nder keto aksidente njeri ka perfunduar me humbje jete, ndersa ne tre te tjeret punonjesit jane derguar per te marre kontrollin e specializuar.

Drejtimi i brendshëm dhe kontrolli

Politikat e drejtimit

- a) rregullat/kodet për drejtimin e brendshëm të njësisë ekonomike, objekt i të cilave është njësia;
- b) rregullat/kodet për drejtimin e brendshëm të njësisë ekonomike, që njësia ka vendosur vullnetarisht të zbatojë;
- c) të gjitha informacionet përkatëse për praktikatat e drejtimit të brendshëm të njësisë ekonomike që zbatohen përtej kërkesave të legjislacionit;

Kontrolli i brendshëm

- a) një përshkrim të tipareve kryesore të sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut të njësisë ekonomike lidhur me raportimin financiar;
- b) përbërjen dhe funksionimin e organeve ekzekutive drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe të komiteteve të tyre;
- c) një përshkrim të politikave të ndryshme të zbatuara lidhur me organet ekzekutive drejtuese dhe mbikëqyrëse të njësisë ekonomike për aspekte të tilla, si: mosha, gjinia apo prejardhja arsimore dhe profesionale, objektivat e këtyre politikave të ndryshme, si janë zbatuar dhe rezultatet për periudhën raportuese.

Raportimi i pagesave për institucionet shtetërore

Njësitë ekonomike që janë aktive në industrinë nxjerrëse hartojnë dhe publikojnë një raport për pagesat që u bëhen institucioneve shtetërore në mënyrë vjetore.

Nuk është nevoja që në raport të merret në konsideratë çdo pagesë, qoftë në formë pagese të vetme apo në formë vargu pagesash të lidhura, nëse është nën vlerën 13,5 milionë lekë brenda një periudhe raportuese. Kur një institucioni shtetëror i bëhen pagesa në natyrë, ato raportohen në vlerë dhe, sipas rastit, në vëllim. Jepen shënimet përkatëse për të shpjeguar se si është përcaktuar vlera.

Raporti i pagesave duhet të japë informacionet e mëposhtme lidhur me veprimtaritë ekonomike, në periudhën raportuese përkatëse:

- a) shumën, gjithsej, të pagesave që u bëhen institucioneve shtetërore;
- b) shumën, gjithsej, për lloj pagese të mëposhtme:
 - i. të drejta prodhimi;
 - ii. tatime sipas legjislacionit tatimor në fuqi;
 - iii. renta minerare;
 - iv. dividendë;
 - v. shpërblime për nënshkrimin, zbulimin dhe prodhimin;
 - vi. tarifa, taksa dhe pagesa të tjera në lidhje me licenca dhe/ose koncesione;
 - vii. pagesa për përmirësime të infrastrukturës.

Në vijim po japim pagesat e kryera nga shoqëria për 3 periudhat e fundit raportuese. Vlerat janë në mijë lekë.

000 lekë	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
TVSH	850,155	808,206	52,448
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	325,784	327,275	297,998
TAP	99,522	105,140	91,408
Tatim ne burim	12,836	2,914	1,700
Tatim fitimi	112,235	52,765	28,993
Taksa vendore	270,290	339,780	198,479
Shuma për tatime	1,670,822	1,636,080	671,026
Renta minerare	484,782	425,207	31,753
Total pagesa	2,155,604	2,061,287	702,779